



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

# Raport

Trajnimi i Avancuar Ndërkombëtar – LEM 2010,  
Stockholm – Suedi



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornong Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

Instituti për Planifikim Hapësinor/Institut za Prostorno Planiranje/Institute for Spatial Planning

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

<b>REFERENCË:</b>					
<b>PËR/ZA/TO:</b>		Z. Mahir Yağcılar, Ministër në MMPH Z. Arben Çitaku, UD Sekretar Permanent në MMPH			
<b>CC:</b>					
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>		Luan Nushi, drejtor në IPH			
<b>NGA/OD/FROM:</b>		Nexhmije Kamberi - Hulumtues profesional Gëzime Grajqevci - Planer profesional			
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>		Raport për pjesëmarrjen në Trajnimin Ndërkombëtar			
<b>Nr. i zyrës:</b>		<b>Lokacioni:</b>		<b>Data:</b>	<b>13.10.2010</b>
<b>Br. kancelarije:</b>		<b>Kucni:</b>		<b>Datum:</b>	
<b>Room No.:</b>		<b>Extension:</b>		<b>Date:</b>	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input type="checkbox"/>
<b>AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE</b>					

Të nderuar,

Të bashkëngjitur gjeni raportin lidhur me pjesëmarrjen në Trajnimin e Avancuar Ndërkombëtar - LEM 2010, Stockholm - Suedi.

# Raport

## Programi i Trajnimit të Avancuar Ndërkombëtar 2010

### *“Menaxhimi i Mjedist Lokal në Zonat Urbane”*

---

**Organizator:** Sida – Sipu International dhe Sweco

**Pjesëmarrësit:** Kandidatët ishin nga vendet e ndryshme: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Moldavi, Gjeorgji, Bellorusi dhe Ukrainë.

**Vendi:** Stockholm – Suedi

**Data:** 04 – 25.09. 2010

---



## Hyrje

Stokholmi, qytet metropolitan i banuar me më shumë se 2 mil. banorë, me karakteristika arkitektonike dhe me zona të rëndësishme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

I shpallur nga Komisioni Evropian, Kryeqyteti i Gjelbër i Evropës 2010 (European Green Capital 2010)  
Pjesët qendrore të qytetit të përbëhen nga katërbëdhjetë ishuj që janë të vazhdueshëm deri te brigjet e Arkipelagos.



## Programi i Trajnimit të Avancuar Ndërkombëtar

Organizata Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Sida është mbështetëse e Programeve lidhur me organizimin dhe ekzekutimin e trajnime të avancuara ndërkombëtare për ngritjen e kapaciteteve të cilat menaxhohen nga personeli i organizatave suedeze ndërkombëtare SIPU dhe SWECO në bashkëpunim me autoritetet suedeze, ekspertë nga sektori privat dhe organizatat e tjera të përfshira në mënyrë aktive në menaxhimin e mjedisit.

Programi i Trajnimit Ndërkombëtar me temën: **“Menaxhimi i Mjedisit Lokal në Zonat Urbane”** është organizuar posaçërisht për persona të kualifikuar për të marrë pjesë në procesin e reformës strategjike për tu njohur me metodat e ndryshimit të projektit në perspektivën afat-gjate të programeve të cilat do të kontribuojnë për përforcimin dhe zhvillimin e kapaciteteve në vendet e pjesëmarrësve, posaçërisht në vendet që janë në tranzicion.

Ky program është përqendruar në mbështetje të projekteve individuale apo ekipore për ndryshime dhe është element për arritjen e konsolidimit demokratik dhe zhvillimit të qëndrueshëm social-ekonomik, në harmoni me mbrojtjen e mjedisit.

Programi ka pas për qëllim aftësimin e pjesëmarrësve në fushën e menaxhimit lokal të mjedisit në zonat urbane, mbrojtjen e interesave publike për përmirësimin e kualitetit të mjedisit në vendet e pjesëmarrësve duke e praktikuar dhe zbatuar përvojën suedeze për menaxhimin e mjedisit.

Gjatë fazës së trajnimit kanë marrë pjesë 25 kandidat nga disa vende të Ballkanit dhe Evropës Lindore të ndarë në pesë grupe. Secilin grup e ka udhëhequr nga një këshilltar për të ndihmuar në zhvillimin e fazave të projektit gjatë trajnimit.

Metodat mësimore gjatë trajnimit kanë qenë interaktive: studime, vizita dhe tema që ndikojnë në procesin e zhvillimit të Projekteve për Ndryshime.

## Modulet të cilat janë prezantuar gjatë fazës së trajnimit janë:

- Përshkrimi Global
- Modelet Suedeze
- Elementet e zhvillimit institucional
- Mjetet e Qeverisjes
- Menaxhimi Publik i Mjedisit Lokal në Praktikë
- Roli i Nivelit Mesatar të Integritimit dhe Koordinimit: Vertikal dhe Horizontal
- Projekti për Ndryshime

Gjatë trajnimit janë organizuar edhe disa vizita në institucione të ndryshme të nivelit qendror dhe lokal.

Vizitë në Zyrën e Bashkimit Evropian  
Vizitë në Agjensionin e Mbrojtjes së Mjedisit  
Vizitë në Komunën Nacka –Departamenti i mbeturinave,  
Vizitë në Arkipelago,  
Vizitë në Hogbytrop-Trajtimi i Mbeturinave  
Vizitë në Husby,  
Vizitë në shtëpitë e këshilltarëve të grupeve të trajnimit,  
Vizitë në Hammarby-Projekt Multidisciplinar.



# Metodat e Menaxhimi të Mjedisit

Parlamenti suedez – Riksdag, për një mjedis të qëndrueshëm, ka miratuar objektivat e cilësisë së mjedisit në 16 zona që duhet të arrihen deri në fund të vitit 2020. Këto objektiva janë monitoruar vazhdimisht nga Këshilli Mbikëqyrës, një organ i posaçëm i emëruar nga Qeveria.

Objektivat e përcaktojnë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit të Suedisë dhe të burimeve të tij natyrore dhe kulturore.

Përgjegjësinë e përgjithshme për arritjen e objektivave mjedisore e ka Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit. Sistemi i objektivave mjedisore përbëhet nga objektivat kombëtare, rajonale dhe lokale të mjedisit, duke e monitoruar progresin përkatësisht nga agjencitë qendrore, bordet administrative të qarkut dhe nga autoritetet lokale.

## Objektivat mjedisore - në Suedi janë:

1. Ajri i pastër
2. Kualiteti i lartë i cilësisë së ujërave nëntokësore
3. Qëndrueshmëria e liqeneve dhe rrjedhave ujore
4. Ligatinat
5. Mjedis i qëndrueshëm dhe i balancuar detar rreth brigjeve të Arkipelagos
6. Eutrofikimi
7. Acidifikimi natyrorë
8. Pyje të qëndrueshme
9. Peisazh me lloje të ndryshme bujqësore
10. Peisazh i malor
11. Kufizimi i ndryshimit të klimës
12. Ambient jo-toksik
13. Mjedis i sigurt ndaj rrezatimit
14. Shtresa mbrojtëse e ozonit
15. Mjedis kualitativ
16. Biodeversiteti i florës dhe faunës




Agjensioni për mbrojtjen e mjedisit në Suedi për përmbushjen e objektivave të lartë përmendura propozon polikat mjedisore dhe zbaton masat në përputhje me ligjet e mjedisit si instrumente për të ndërtuar një mjedis i cili mund të përdoret nga ana e Qeverisë si bazë për vendimmarrje.

## Emetimet e dioksidit të karbonit në Suedi

Suedia është një nga pak vendet e industrializuara që kanë reduktuar emetimet e karbonit. Ndërmjet 1990 dhe 2006, këto janë reduktuar në 9 %. Gjatë të njëjtës periudhë, ekonomia u rrit 44 %. Kjo rezulton për faktin se nafta nuk është burim primar që përdoret për qëllime të ngrohjes, pasi që është zëvendësuar në masë të madhe me biogas. Kështu që krahasuar me vitin 1980 kur në atmosferë është liruar një sasi prej 80.000 ton dioksid karboni, ndërsa në vitin 2006 emetimi ka qenë pak më shumë se 51.500 ton.

## Emetimet e dioksidit të karbonit në Suedi

Suedia është një nga pak vendet e industrializuara që kanë reduktuar emetimet e karbonit. Ndërmjet 1990 dhe 2006, këto janë reduktuar në 9 %. Gjatë të njëjtës periudhë, ekonomia u rrit 44 %. Kjo rezulton për faktin se nafta nuk është burim primar që përdoret për qëllime të ngrohjes, pasi që është zëvendësuar në masë të madhe me biogas. Kështu që krahasuar me vitin 1980 kur në atmosferë është liruar një sasi prej 80.000 ton dioksid karboni, ndërsa në vitin 2006 emetimi ka qenë pak më shumë se 51.500 ton.



Niveli i emetimeve të dioksidit të karbonit në Suedi i reduktuar për 16 % mes viteve 1996 dhe 2006

## Menaxhimi i mbeturinave


Në bazë të planit për menaxhimin e mjedisit si dhe standardeve për një mjedis të qëndrueshëm Suedia përdor një sistem të integruar të mbeturinave. Çdo substancë apo objekt që ka nevojë të largohet nga përdorimi, ose është e nevojshme të hidhet është mbeturinë sipas Direktivës së Mbeturinave (Direktiva Evropiane (WFD) 2006/12/EC), e cila ndryshohet me direktivën (Direktiva 2008/98/EC), që vjen në fuqi në dhjetor 2010.

Karakteristikat e menaxhimit suedez të mbeturinave:

- Anëtare e BE-së që nga Janari 1995
- Përgjegjësi komunale të përcaktuar mirë për menaxhimin e mbeturinave
- Ndalesa për depozitë e mbeturinave djegëse nga viti 2002 dhe mbeturinave organike nga viti 2005
- Objektivat kombëtar të mjedisit edhe për mbeturinat

Përgjegjësit e menaxhimit të mbeturinave janë:

- Komuna,
- Departamenti i mjedisit ,
- Agjensioni për mbrojtjen e mjedisit .





## Vizita në Nacka dhe Hogbytrop

Gjatë trajnimit vizituam Hogbytropin, zonë e planifikuar për grumbullimin e mbeturinave si dhe ndarjen e tyre.

Ndërsa, gjatë vizitës në komunën Nacka kemi parë mënyrën e grumbullimit, selektimit të mbeturinave si dhe përdorimin e tyre si lëndë e parë.

Shembuj nga përpunimi i qelqit.



*Shkrirja e qelqit të ricikluar*



*Produkti final nga qelqi i ricikluar*



*Dyshemeja nga qelqi*

Mbeturinat dërgohen në deponi, e cila është e pajisur me kontenjerë, përmes të cilëve bëhet seleksionimi i mbeturinave në bazë të llojit: metalit, qelqit, drurit, plastikës, letrës, tekstilit etj.



## Planifikimi Hapësinor - këndvështrimi suedez

Duke parë nevojën urgjente për të përmirësuar kualitetin e jetesës për zhvillimin e qëndrueshëm, Planifikimi Urban dhe Menaxhimi i Mjedisit duhet të kenë potencial për të trajtuar sfidat urbane me të cilat përballen qytetet në shekullin e 21.


Urbanizimi është një nga proceset globale që do të ketë një ndikim të madh në parakushtet për zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë. Zhvillimi i qëndrueshëm urban është një nga gjashtë fushat kyçe për mbështetjen e veçantë të Qeverisë suedeze për mjedis dhe planifikim, ku të gjithë qytetarët do të kenë mundësi për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës dhe në këtë mënyrë mund të kontribuojnë më tej në zhvillimin e qytetit të tyre.

Çështjet e përbashkëta globale përfshijnë ndryshimin e klimës, krizën ekonomike, pabarazinë në të ardhura dhe diversitetin kulturor.

Një nga objektivat kryesore të konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm është që Qytetit duhet të promovojë një qasje të integruar dhe multidisiplinare, duke u fokusuar në sinergjitë midis fushave të mundshme, pasi kjo mund të kontribuojë për zgjidhje më të mirë në fund dhe një përdorim më efikas të burimeve natyrore për zhvillimin e qëndrueshëm urban të shoqëruar me uljen e varfërisë.

Nga 3 miliard banorë që jetojnë në zonat urbane, sot, rreth 1 miliard jeton në "lagjet e varfëra", me mungesë të ujit të pastër dhe kanalizimit me kushte të pamjaftueshme.

Prandaj, janë aplikuar metoda të planifikimit si bazë për një zhvillim të parimeve për rrethet e qytetit të gjelbër, përdorimin e integruar e tokës, të transportit dhe zonave të gjelbëra, planifikimin e zonës, projektimit të qëndrueshëm të ndërtimit, si dhe strategjitë për zvogëlimin e ndotjes së mjedisit.



Në fund të trajnimit me ndihmën e këshilltarit është përgatitur një draft dokument i elaboruar nëpër fazat e Projektit për Ndryshime. Pastaj, nga të gjithë pjesëmarrësit është bërë evaluimi i punës gjatë tri javëve të trajnimit dhe secili kandidat ka marrë nga një Çertifikatë si dëshmi e vijimit të trajnimit.

